



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 29.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "N.T.SH OFFICE-TRADE str.Rexhep Mala nr.26 -Prishtine", për aktivitetin: "**Furnizimi me rekuizita sportive** Nr. të Prok: 616 20 103 121 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "N.T.SH OFFICE-TRADE str.Rexhep Mala nr.26 -Prishtine" "e datës 26.09.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnzim me rekuizita sportive" Nr. të Prok: 616 20 103 121 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 23.09.2020 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 23.09.2020 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "NTSH OFFICE TRADE" me datë 26.09.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ' **Furnzim me rekuizita sportive** ' me Nr. të Prok: 616 20 103 121

Autoriteti Kontraktues, me datë 29.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Lidhur me pretendimet tuaja se plotesoni kerkesat teknike profesionale eshte i pa bazuar per arsye ne vijim:

-Ne oferten tuaj ju keni dorezuar listene e kontratave te realizuara pa specifikuar ndaras vlerat e furnizimeve te ngjajshme,pa deshmi per realizimin e tyre dhe deshmi te kontratave.Bazuar ne keto mangesi e duke u bazuar ne nenin 72 te LPP-se Autoriteti Kontraktues ka kerkuar sqarimet shtese nga ju.Ne sqarimet eofruara ju keni sjellur kontrate,reference dhe fatura te dorezimit te mallit te OE-ik "Letra Com".Nga faturat e dorezuara te ky OE-ik shihet se dorezimi i mallit eshte bere me datat 07.07.2017 dhe dhe 29.04.2017,qe d.t.th.se keto kontrata jane permbyllur para me shume se tri vite prej dates se publikimit te tenderit(10.07.2020).

Edhe ne deshmite tjera te kerkuara dhe te dorezuara eshte vertetuar se ju nuk keni plotesuar kerkesat lidhur me referencat dhe tenderi juaj eshte i pa pergjegjshem.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit